SHOQËRIA"OST SECURITY" sh.a

PASQYRAT FINANCIARE Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013

TIRANË

OPERATORI SISTEMIT TË TRANSMETIMIT
ost security

Përmbajtja

Raporti i Auditorëve të Pavarur

I. **Pasqyra e Pozicionit Financiar**

II. **Pasqyra e Të Ardhurave Gjithpërfshirëse**

III. **Pasqyra e Ndryshimit të Kapitalit**

IV. **Pasqyra e Flukseve Monetare**

V. **Shënimet shpjeguese të Pasqyrave Financiare**

OPERATORI SISTEMIT TË TRANSMETIMIT
OST security

Fatime Alliu
License Nr. 166, date 21.09.2007

Raport i Auditoreve të Pavaruar

01 Janar 2013 deri më
31 Dhjetor 2013

Drejtuar: Drejtuesve dhe Aksionerëve

Ne kemi audituar Pasqyrat Financiare (Bashkëlidhur) të shoqërisë ***"OST SECURITY " sh.a*** (Këtej e tutje referuar si "Shoqëria") të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datë 31 Dhjetor 2013, pasqyrën e të ardhurave gjithpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital, pasqyrën e fluksit të parasë për vitin e përfunduar në këtë datë dhe një përmbledhje të politikave më të rëndësishme kontabël si dhe informacionin tjetër shpjegues.

Përgjegjësia e Drejtimit për Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me "*Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar*" dhe ligjin Nr.9228 "*Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare*", dhe për ato kontrolle të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Përgjegjësitë e Audituesit

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion për pasqyrat financiare duke u bazuar në auditimin tonë. Ne e kemi kryer auditimin tone në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të respektojmë kërkesat etike dhe të planifikojmë e kryejmë auditimin për të arritur siguri të arsyeshme për faktin nëse pasqyrat financiare nuk përmbajnë anomali materiale.

Një auditim përfshin kryerjen e proçedurave për të siguruar evidencën e auditimit rreth shumave dhe informacioneve shpjeguese të dhënë në pasqyrat financiare. Proçedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, përfshirë vlerësimin e rreziqeve të anomalisë materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo të gabimit. Gjatë kryerjes së këtyre vlerësimeve të rrezikut, audituesi merr në konsideratë kontrollin e brendshëm në lidhje me përgatitjen dhe paraqitjen e drejte të pasqyrave financiare të entitetit, në mënyrë që të përcaktojë proçedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinioni për efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit. Një auditim përfshin gjithashtu vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërisë së çmuarjeve kontabile të bëra nga drejtimi, sikurse edhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Alliu fu

OPERATORI SISTEMIT TË TRANSMETIMIT OST security

Ne besojmë se evidenca e auditimit që ne kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë të auditimit.

Opinion

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin në të gjitha aspektet materiale, në mënyrë të drejtë, pozicionin financiar të shoqërisë ***"OST SECURITY" sh.a*** më datë 31 Dhjetor 2013, performancën e saj financiare dhe flukset e parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

Eksperte Kontabël e Regjistruar
Fatime Alliu

Eksperte Kontabel e Autorizuar
FATIME ALLIU
NIPT: K 72215028 T

License Nr. 166, date 21.09.2007

OPERATORI SISTEMIT TË TRANSMETIMIT
ost security

Tirane,më 23/03/2014

I. Pasqyra e Pozicionit Financiar

	Ref.	*Për vitin e mbyllur më 31.12.2013*	*Për vitin e mbyllur më 31.12.2012*
AKTIVET			
Aktivet afatgjata	4	**527,508**	**684,524**
Aktivet afatgjata materiale		527,508	**684,524**
Investime Proces		-	-
Aktive te qendrueshme ne magazine		-	-
Aktivet afatgjata jomateriale		-	-
		527,508	**684,524**
Aktivet afatshkurtra			
Inventarë	5	221,213	926,293
Llogari te arketueshme tregetare	6	14,548,706	11,621,481
Llogari te arketueshme e te tjera	6	241,355	293,886
Shpenzime per tu shperndare	7	3,172,171	1,807,217
Mjetet monetare ne arke e ne banke	8	1,698,302	760,622
		19,881,746	**15,409,499**
Totali i aktiveve		**20,409,255**	**16,094,022**
KAPITALI DHE DETYRIMET		**3,279,191**	**2,147,561**
Kapitali			
Kapitali aksionar	9	4,000,000	**4,000,000**
Rezerva nga rivleresimi		-	-
Rezerva te tjera (zhvillimi)		-	-
Rezerva ligjore		-	-
Fitime/Humbje te mbartura		- 1,852,439	-
Fitimi /Humbje e ushtrimit	21	1,131,630	- **1,852,439**
Totali i kapitalit		**3,279,191**	**2,147,561**
DETYRIMET			
Detyrime afatgjata		-	-
Hua afatgjata		-	-
Tatimi i shtyre mbi fitimin		-	-
Grante,te ardhura te shtyra e te tjera detyrime		-	-
Detyrime te tjera afatgjata		-	-
		-	-
Detyrime afatshkurtra		**17,130,064**	**13,946,462**
Hua afatshkurtra		-	-
Llogari te pagueshme	10	264,522	**209,857**
Detyrime ndaj punonjesve	11	5,817,270	**5,642,509**
Detyrime Tatimore	12	4,808,701	**5,182,462**
Llogari te pagueshme te tjera	13	6,239,572	**2,911,633**
		17,130,064	**13,946,462**
Totali i detyrimeve		**17,130,064**	**13,946,462**
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		**20,409,255**	**16,094,022**

Administratori
Rustem Ulluqi

Shefe e Financës
Afrime Hatëçaj

II. Pasqyra e Të Ardhurave Gjithpërfshirëse

	Ref	*Për vitin e mbyllur më 31.12.2013*	*Për vitin e mbyllur më 31.12.2012*
Te ardhura nga shitja	14	118,645,992	113,429,304
Te ardhura te tjera operative	15	1,421,103	874,178
Materiale te para dhe te konsumueshme.	16	(3,250,181)	(2,975,657)
Shpenzime personeli	17	(108,717,745)	(106,938,258)
Shpenzime zhvlerësimi dhe amortizimi	18	(157,015)	(195,679)
Shpenzime te tjera	19	(6,824,942)	(6,078,351)
Fitimi operativ		**1,117,212**	**(1,884,463)**
Te ardhurat/shpenzime financiare nga njesite e kontrolluara(neto)		-	-
Te Ardhura /Shpenzime financiare Neto	20	14,418	32,025
Total shpenzime financiare		14,418	32,025
Fitimi (Humbje) para tatimit	21	**1,131,630**	**(1,852,438)**
Efektet e tatimit te shtyre			
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin		-	-
Fitimi (Humbje) i vitit		**1,131,630**	**(1,852,438)**
Te ardhura te tjera gjithëpërfshirëse		-	-
Totali i te ardhurave te tjera gjithëpërfshirëse			
Fitimi qe i atribuohet aksionareve te kompanisë mëmë		-	-
Totali i te ardhurave gjithëpërfshirëse qe i përket aksionerëve të kompanisë mëmë	**21**	**1,131,630**	**(1,852,438)**

Rustem Kurtaj

OPERATORI I SISTEMIT TE TRANSMETIMIT ol-OST security

Afrim Haklaj

III. Pasqyra e Ndryshimit të Kapitalit

	Kapitali i aksionar	Rezerva ligjore	Rezerva te tjera (zhvillimi)	Fitime te Mbarutara /Humbje te akumuluara	Fitimi (humbje) e vitit financiar	Totali
01 Janar 2012	**4,000,000**	-	-	-	-	**4,000,000**
						-
Miratimi i shpërndarjes sw fitimit tw vitit 2011						-
Transaksionet me pronaret	**4,000,000**	-		-	-	**4,000,000**
Fitimi (humbje) neto për periudhën kontabël 2012					**(1,852,438)**	**(1,852,438)**
Pozicioni më 31 dhjetor 2012	**4,000,000**	-	-	- -	**1,852,438**	**2,147,562**
31 Dhjetor 2012	**4,000,000**	-	-	- -	**1,852,438**	**2,147,562**
01 Janar 2013	**4,000,000**	-	-	**0**	**(1,852,438)**	**2,147,562**
Miratatimi I Shpërndarja e fitimit te vitit 2012				(1,852,438)	1,852,438	-
Transaksionet me pronaret	**4,000,000**	-	- -	**1,852,438**	-	**2,147,562**
Fitimi (humbje) neto për periudhën kontabël 2013					**1,131,630**	**1,131,630**
Pozicioni më 31 dhjetor 2013	**4,000,000**	-	- -	**1,852,438**	**1,131,630**	**3,279,192**
31 Dhjetor 2013	**4,000,000**	-	- -	**1,852,438**	**1,131,630**	**3,279,192**

Referoju shënimeve shpejguese të pasqyrave financiare

OPERATORI I SISTEMIT TË TRANSMETIMIT OST security

IV. Pasqyra e Flukseve Monetare

	Për vitin e mbyllur më 31.12.2013	*Për vitin e mbyllur më 31.12.2012*
Fluksi monetar nga aktivitetit Operative		
Fitimi para tatimit	**1,131,630**	**(1,852,438)**
Rregullime për zera jo-monetare :		
Zhvleresimi I AAM	*157,015*	*195,679*
Amortizimi i AAJM		
Tatim fitimi i ushtrimit	-	-
Tatimi i Shtyre mbi Fitimin		
Fitimi Operative para ndryshimeve ne Kapitalin Q	**1,288,645**	**(1,656,759)**
Levizjet ne Kapitali Qarkullues		
Rritje/rënie në tepricën inventarit	705,081	22,190
Rritje(-)/rënie(+) në të arkëtueshme	(2,927,225)	(1,049,534)
Rritje(-)/rënie(+) në të arkëtueshme te tjera	52,531	489,703
Rritje/rënie në llogarite e Pagueshme	(144,337)	(1,350,387)
Rritje/rënie në llogarite e Pagueshme te tjera	3,327,939	2,396,009
Rritje/renie ne parapagime Shpenzime te shtyra	(1,364,955)	580,368
Rritje/renie ne Grante dhe te ardhura te shtyra	-	-
Mjetet Monetare neto nga aktivitetet Operative	-	-
	(350,966)	**1,088,350**
Aktivitetit investuese		
Blerja e aktiveve afatgjata materiale	-	(260,883)
Rivleresimi i aseteve	-	
Te hyrja nga shitja e Aktiveve Afagjate Materiale	-	
Interesi i arkëtuar	-	
Mjete Monetare neto e përdorur në aktivitetet invest	-	**(260,883)**
Aktivitetit financiuese		
Të ardhura nga emetimi i kapitalit aksioner	-	-
Financuar humbja	-	402,102
Të ardhura nga huamarrje afatgjata	-	-
Dividendët e paguar	-	-
Mjete Monetare neto e përdorur në aktivitetet financia	-	**402,102**
Rritja (+)/rënia(-) neto e mjeteve monetare	**937,679**	**(427,190)**
Mjetet monetare në fillim të periudhës kontabël	**760,622**	**1,187,812**
Mjetet monetare në fund të periudhës kontabël	**1,698,302**	**760,622**

Rustem Mehmeti

OPERATORI I SISTEMIT TË TRANSMETIMIT
Prost security

Afrime Hakiaj

V. Shënimet shpjeguese të Pasqyrave Financiare

1. Informacion i përgjithshëm

Shoqëria "OST **SECURITY**" sh.a është regjistruar në QKR më 01/12/2010 .

Kapital të regjistruar i shoqërisë është 4,000,000 lekë me 100% aksione të OST sh.a .

Nr. NIPT-i L02401001R , me seli ne adresen; Rruga "Frosina Plaku", Kompleksi Home Plane, pallati nr.2 ,Tirane.

Përfaqësuesi Ligjor i shoqërisë është z.**Rustem MURATI**

Veprimtaria saj rregullohet sipas Ligjit Nr.9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite Tregatre" dhe statusi i saj.

Objekti i kesaj shoqerie eshte: Sigurimi dhe ruajtja e objekteve ne pronesi dhe administrim te OST sh.a.Shoqeria mund te siguroje dhe te ruaje objekte ne pronesi apo administrim te shoqerive ku OST sh.a eshte aksioner i vetem. Sigurimi dhe mbrojtja e jetes dhe e shendetit te personave,ne funksion te realizimit te objetkti funnksionimit.

Nr.i Punonjesve mesatar 171 punonjës

Shoqeria drejtohet nga Keshilli Mbikqyres i emeruar nga administratori i OST sh.a.

Këshilli Mbikqyrës përbëhet:

1. Syphije Xhepa Kryetare
2. Ilda Nushi Anëtare
3. Genci Dango Anëtar
4. Juliana Lamaj Sekretare

Gjate periudhes 01.01.2013 deri me 31.12.2013 shoqeria ka kryer aktivitetin e saj ne perputhje me objektin e krijimit te saj.

2. Politikat kontabël

Shoqeria "OST SECURITY" sha është krijuar me kapital 100% të OST sh.a per qellime të veçanta te OST sha, keshtu qe edhe politikat kryesore kontabel te adoptuara per pregatitjen e ketyre pasqyrave financiar, jane paraqiten pothuajse të njejta me **OST sha,** pavaresisht paraqitjes/listimit te tyre, **jo te gjitha jane te zbatueshme per t`u aplikuar per kete shoqeri,** menyra e paraqitjese se tyre eshte e detyrueshme per efekt të konsolidimit të pasqyrave financiare të shoqerise mëmë (OST sha.)

Këto politika jane zbatuar në mënyre konsistente në te gjithe vitet e paraqitura perveç kur percaktohet ndryshe:

2.1 Bazat e Përgatitjes

Pasqyrat financiare jane pregatitur ne perputhje me Standartet Nderkombetare te Raportimit Financiar (SNRF) te publikuara nga Bordi i Standarteve Nderkombetare te Kontabilitetit ("IASB") dhe interpretimeve te publikuara nga Komiteti i Interpretimeve te Raportimeve Financiare Nderkombetare ("IFRIC") te IASB.

Pasqyrat financiare jane pregatitur duke perdorur bazat e vleresimit te specifikuara nga SNRF per çdo klase te aktiveve, detyrimeve, te ardhurave gjithperfshirese. Bazat e matjes pershkruhen ne detaje ne politikat kontabel te me poshtme.

Pergatitja e pasqyrave financiare ne perputhje me SNRF kerkon perdorimin e disa çmuarjeve kritike kontabel.Gjithashtu kjo kerkon që drejtimi te perdore gjykimin e tij ne procesin e perdorimit te politikave kontabel te Shoqerise. Fushat qe perfshijne nje nivel te larte gjykimi

OPERATORI SISTEMIT TË TR... ost security

apo kompleksiteti ose fushat ku supozimet dhe çmuarjet jane te rendesishme per pasqyrat financiare paraqiten ne shenimet perkatesisht.

Pasqyrat financiare jane pergatitur per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2013.Te dhenat krahasuese pasqyrojne gjendjen e pozicionit finaciar te shoqerise ne 31 Dhjetor 2012.

✓ ***Monedha Funksionale dhe Prezantimi***

Zërat e perfshire ne pasqyrat financiare te Shoqerise maten duke perdorur monedhen e mjedisit kryesor ekonomik ne te cilin Entiteti operon (monedha funksionale). Pasqyrat financiare jane paraqitur ne Leke, e cila eshte monedha e prezantimit te Shoqerise.

2.2 Përmbledhje të Politikave të Rëndesishme Kontabël

a) Transaksione dhe balancat ne Monedhat e Huaja

Ne pregatitjen e pasqyrave financiare te Shoqerise, transaksionet ne monedha te ndryshme krahasuar me monedhen funksionale te Shoqerise (monedhat e huaja) rregjistrohen me kursin e kembimit te dates se transaksionit. Ne çdo date te Pasqyres se pozicionit financiar, aktivet dhe detyrimet monetare qe jane ne monedha te huaj perkthehen me kursin e kembimit te dates se Pasqyres se pozicionit financiar. Diferencat nga kembimi njihen ne fitim ose humbje ne periudhen ne te cilen lindin. Aktivet dhe detyrimet jo-monetare qe jane njohur me kosto historike ne monedhe te huaj perkthehen me kursin e kembimit ne daten e transaksionit. Aktivet dhe detyrimet ne monedha te huaja dhe qe jane paraqitur me vlere te drejte perkthehen ne monedhen funksionale me kursin e kembimit ne daten qe eshte percaktuar vlera e drejte.

	2013	2012
1 Euro	140.2	139.59
1 USD	101.86	105.85

b) Njohja e të Ardhurave dhe Shpenzimeve

✓ ***Te ardhurat***

Te ardhurat njihen ne masen qe eshte e mundur qe perfitime ekonomike do te hyjne ne Shoqeri dhe qe te ardhurat mund te maten ne menyre te besueshme, pavaresisht se kur behet pagesa. E ardhura matet me vlere te drejte te shperblimit te mare per sherbimin e shitur, neto nga tatimi mbi vleren e shtuar dhe zbritje te mundshme te shitjeve.Kriteri specifik i njohjes duhet te arrihet para se te njihen si te ardhura.

✓ ***Shpenzimet***

Shoqeria njeh shpenzimet ne pasqyren e te ardhurave gjitheperfshirese ne proporcion me kryerjen e tyre ne daten e raportimit. Shpenzimet paraqiten ne pasqyren e te ardhurave gjitheperfshirese sipas natyres se tyre, çka kerkon gjykim te konsiderueshem nga drejtimi i shoqerise.

✓ ***Te Ardhurat & Shpenzimet nga Interesat***

Te ardhurat nga interesi njihen ne pasqyren e te ardhurave gjitheperfshirese kur ato ndodhin, duke marre ne konsiderate metoden e interesit efektiv *(nese ka).*

Shpenzimet per interesa perfshijne interesin e pagueshem mbi borxhin e marre, duke perdorur metoden e

normes efektive te interest. Interesat njihen ne propocion me kohen qe reflekton te ardhuren efektive nga aktivi.

c) Tatimet

✓ ***Tatimi mbi fitimin***

Aktivi dhe pasivi per tatimin mbi fitimin per periudhen aktuale maten me shumat e pritura per t'u marre nga apo per t'u paguar tek organet tatimore. Norma e tatimit dhe ligjet per tatimet e perdorura per llogaritjen e vleres se tatim fitimit jane ato te nxjerra ose te publikuara ne daten e raportimit ne vend (Shqiperi) ku Shoqeria operon dhe siguron te ardhura te tatueshme.Tatim

mbi fitimin aktual qe lidhet me zera të njohur direkt në kapital njihet në kapital dhe jo ne pasqyren e te ardhurave. Drejtimi vlereson ne menyre periodike pozicionet e ndermarra ne formularet e deklarimit te pagesave ne lidhje me situata ne te cilat rregulloret e aplikueshme per tatimet jane subjekt i interpretimeve, si dhe njeh provizione nese eshte e pershtatshme.

- ✓ ***Tatimi fitimi i shtyre***

Tatimi mbi fitimin i shtyre sigurohet duke perdorur metoden e detyrimit mbi diferencat e perkohshme ndermjet bazes fiskale te aktiveve dhe detyrimeve dhe vlerave te mbartura te tyre per qellime te raportimit financiar ne daten e raportimit.

Detyrimet per tatim fitimin e shtyre njihen per te gjitha diferencat e perkohshme te tatueshme, pervec:

- ✓ Kur detyrimi per tatim fitimin e shtyre lind nga njohja fillestare e emrit te mire ose nje aktiv apo detyrim nga nje transaksion qe nuk eshte kombinim biznesi dhe qe ne kohen e transaksionit, nuk ndikon as ne fitimin kontabel dhe as ne fitimin apo humbjen e tatueshme;
- ✓ Ne lidhje me diferencat e perkohshme te lidhura me investimet ne filiale, bashkepronesi dhe interesa ne sipermarrjet e perbashketa,kur koha e rikthimit te diferencave te perkohshme mund te kontrollohet dhe ka te ngjare qe diferencat e perkohshme nuk do te kthehen mbrapsht ne te ardhmen e parashikueshme .

Tatim fitim i shtyre aktiv njihet per te gjitha diferencat e perkohshme te zbritshme, kreditet e tatimi fitimit te paperdorur te mbartur dhe humbjeve te tatueshme te pa perdorura. Tatim fitimi i shtyre aktiv njihet ne masen qe eshte e mundur qe do te kete fitim te tatueshem per kundrejt diferencave te perkohshme te zbritshme, dhe kreditet e tatimi fitimit te paperdorur te mbartur dhe humbjeve te tatueshme te pa perdorura mund te perdoren, pervec:

- ✓ Kur tatim fitimi i shtyre aktiv qe lidhet me diferenca te perkoheshme te zbritshme lind prej njohjes fillestare te nje aktivi apo detyrimi nga nje transaksion qe nuk eshte kombinim biznesi dhe qe ne kohen e transaksionit, nuk ndikon as fitimin kontabel dhe as fitimin apo humbjen e tatueshme;
- ✓ Ne lidhje me diferencat e perkohshme te zbritshme qe lidhen me investimet ne filiale, bashkepronesi dhe interesa ne sipermarrjet e perbashketa, tatim fitimi i shtyre aktiv njihet ne masen qe eshte e mundur qe diferencat e perkohshme do te rikthehen ne te ardhmen e afert dhe qe do te kete fitime te tatueshme perkundrejt te cilave mund te perdoren diferencat e perkohshme.

Vlera e mbartur e tatim fitimit te shtyre aktiv rishikohet ne cdo date raportimi dhe reduktohet ne masen qe nuk eshte me e mundur qe te kete fitim te tatueshem mjaftueshem qe te lejoje perdorimin e tatim fitimit te shtyre aktiv pjeserisht ose komplet.Tatim fitim i shtyre aktiv i panjohur rivleresohet cdo date raportimi dhe njihet ne masen qe eshte bere e mundur qe fitime te tatueshme te ardhshme do te mundesojne rimarrjen e tatim fitimit te shtyre aktiv.

Tatim fitimi i shtyre aktiv apo pasiv matet me normat tatimore qe pritet te perdoren ne vitin kur aktivi eshte realizuar ose detyrimi eshte paguar, bazuar ne normat tatimore (dhe ligjet tatimore) qe jane publikuar ose qe jane publikuar ne pjesen me te madhe te tyre ne daten e raportimit.

Tatim fitimi i shtyre qe lidhet me zerat te njohur jashte fitimit apo humbjes, njihen jashte fitimit apo humbjes. Zerat e tatim fitimit te shtyre njihen ose ne te ardhurat gjitheperfshirese ose direkt ne kapital ne menyre reciproke me transaksionin themelor.

Tatim fitimi i shtyre aktiv ose tatim fitimi i shtyre pasiv kompensohen nese ekziston nje e drejte ligjore e detyrueshme per te kompensuar tatim fitimin e shtyre aktiv aktual kundrejt tatim fitimit te shtyre pasiv aktual dhe qe tatim fitimi i shtyre lidhet me te njejtin entitet dhe te njejtin organ tatimor.

Perfitimet tatimore te siguruara si pjese e kombinimit te biznesit, por qe nuk plotesojne kushtin e njohjes se vecuar ne ate date, do te njihen me pas nese do te kete ndryshuar informacioni i ri ne lidhje me faktet dhe rrethanat.Rregullimi do te trajtohet ose si reduktim i emrit te mire sikur

OPERATORI SISTEMIT TE TRANSMETIMIT ost security

te ishte hasur gjate periudhes se matjes (persa kohe qe nuk e tejkalon emrin e mire) ose ne fitim ose humbje.

Shoqeria nuk ka njohur tatime te shtyra.

d) Aktivet Afagjate (AAM-t&AAJM-t)

Aktivet Afagjate Materiale (AAM-t)

✓ ***Njohja dhe Matja***

Zërat e llogarise toka, ndertesa, makineri dhe pajisje jane te paraqitura me vleren e drejte duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar..

Te gjitha aktivet e tjera afat-gjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjëndje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes si në gjëndjen e mëparshme të vendodhjes së aktivit.

Kostoja e aktiveve te kualifikuara perfshin kostot e interesit te kryera gjate periudhave te ndertimit(nese ka) bazuar ne normen mesatare te maturuar te huadhenies. Nje Softëare i blere qe eshte thelbesor per funksionimin e pajisjes perkatese kapitalizohet si pjese e asaj pajisje.

Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndertimi tij.

Në rastet kur pjesë të një aktivi afat-gjate materiale kane jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentet më të mëdhenj) të aktiveve afat-gjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur, dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave.

✓ ***Kostot e Mëpasshme (mëvonëshme)***

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afat-gjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afat-gjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

✓ ***Zhvlerësim***

Zhvleresimi njihet ne pasqyren permbledhese te te ardhurave Gjithperfshirese duke perdorur metoden lineare, sipas jetes ekonomike te parashikuar te perdorimit. Toka dhe aktivet ne proces nuk zhvleresohen.

Jetegjatesia e parashikuar dhe normat e zhvleresimit te aktiveve per periudhen aktuale jane si me poshte:

Shoqeria ka perdorur normat fiskale :

Llojet e Aktiveve te Qendrueshme	Normat e aplikuara	Metoda e aplikuar
Makineri dhe pajisje	20%	Me vlere te mbetur
Mjete transporti	20%	Me vlere te mbetur
Mobilje dhe Qendi	20%	Me vlere te mbetur
Te tjera	20%	Me vlere te mbetur
Pajisje Informatike	25%	Me vlere te mbetur

Normat vjetore te amortizimit te perdorura, bazuar ne Ligjin 8438 date 28.12.1998 "Per tatimin mbi te ardhurat" ,i ndryshuar dhe Udhezimit te Ministrise se Financave No.5 date 30.01.2008

- ✓ *Ç'regjistrimi*

Nje ze i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashte perdorimit apo kur nuk priten me perfitime ekonomike te ardhshme nga perdorimi apo nxjerrja e tij jashte perdorimit.

Fitimet dhe humbjet ne rastin e nxjerrjes jashte perdorimit te aktiveve afatgjata materiale percaktohen sipas shumes se tyre te mbetur dhe merren parasysh ne nxjerrjen e rezultatit operativ te ushtrimit.

Aktivet Afat Gjate Jo-Materiale (AAJM-t)

Aktivet afatgjata jo-materiale perfshijne liçensat, te drejtat per perdorim dhe emri i mire, softëere etj..

- ✓ ***Njohja dhe matja***: Entiteti njeh një aktiv Afatgjate Jo-Material kur plotëson kriterin e identifikueshëm si i tille :
  - *a) është i ndashëm, dmth. ka mundësi të ndahet apo të veçohet nga njësia ekonomike dhe të shitet, transferohet, liçensohet, jepet me qira dhe këmbehet, qoftë individualisht apo sëbashku me një kontratë, aktiv ose detyrim të lidhur;* ***ose***
  - *b) vjen nga të drejtat kontraktuale apo të drejta të tjera ligjore, pavarësisht nëse këto të drejta janë të transferueshme apo të ndashme nga njësia ekonomike ose nga të drejta apo detyrime të tjera.*
- ✓ ***Shpenzimet e mevonshme*** mbi aktivet afatgjata jo-materiale kapitalizohen vetem kur keto shpenzime lidhen me rritjen e perfitimit te ardhshem ekonomik prej aktivit.Te gjitha shpenzimet e tjera njihen ne periudhen qe ndodhin ne pasqyren e vecante permbledhese te te ardhurave.
- ✓ ***Shpenzimi i amortizimit:*** njihet bazuar mbi metoden lineare te amortizimit gjate jetes se dobishme ekonomike, prej dates ne te cilen aktivi eshte i gatshem per perdorim. Norma e amortizimit eshte sipas legjislacionin fiskal 15% ne vit metoda linare.
- ✓ ***Amortizimi***: Aktivet afatgjata jo-materiale te blera nga Entiteti paraqiten me kosto minus zhvleresimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluara nga renia ne vlere.

Rënia në Vlerë të Aktiveve Afatagjatë (AAM-t&AAJM-t)

Shoqeria sipas politikes kontabele rishikon ne çdo date raportimi, shumen e mbartur te aktiveve materiale dhe jo materiale ne menyre qe te percaktoje nese ekziston ndonje tregues qe keto aktive te kene pasur humbje si rezultat i nje renie ne vlere.

Ne rast se keto tregues ekzistojne, atehere vleresohet vlera e rikuperueshme e aktivit me qellim qe te percaktohet masa e humbjes, nese ka. Ne rast se nuk eshte e mundur te vleresohet vlera e rikuperueshme per nje aktiv te vecante, shoqeria përcakton ne total rrjedhen e parase te gjeneruar nga njesia se ciles i perket aktivi.

Vlera e rikuperueshme eshte vlera me e larte midis vleres se tregut minus kostot e shitjes dhe vleres se tij te perdorimit. Per te vleresuar vleren ne perdorim, rrjedhjet e ardhshme te parashikuara te parase aktualizohen nga vlera e tyre ekzistuese duke perdorur nje norme aktualizimi pa llogaritur tatimet, e cila reflekton vleresimet aktuale te tregut te vleres monetare ne kohe dhe rreziqet specifike qe kane lidhje me ate aktiv per te cilin vleresimi i njedhes se ardhshme te parase nuk eshte rregulluar.

Nese vlera e rikuperueshme e nje aktivi apo rrjedha e parase se gjeneruar eshte vleresuar te jete me e vogel se vlera kontabel, atehere vlera kontabel e aktivit do te zvogelohet deri ne vleren e rikuperueshme te tij. Humbja nga renia ne vlere njihet menjehere ne pasqyren e ndermjetme pembledhese te te ardhurave.

Nese nje humbje nga renia ne vlere rimerret, vlera kontabel apo rrjedha e gjeneruar e parase do te rriten deri ne vleren e rishikuar te rikuperueshme, duke mos kaluar vleren e mbartur te aktivit qe do te ishte percaktuar ne rast se nuk do te ishte njohur asnje humbje nga renia ne vlere ne vitet paraardhese. Kthimi i humbjes nga renia ne vlere njihet menjehere ne pasqyren e ndermjetme permbledhese te te ardhurave.

Shoqeria nuk ka percaktuar Renie nëvlerë.

OPERATORI SISTEMIT TË TRANSPORTIMIT ost security

***e)* Instrumentat Financiare**

Instrumentat financiare te Shoqerise per vitin qe mbyllet me 31 Dhjetor 2013 dhe per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2012 perbeheshin nga instrumentat jo-derivative: paraja dhe ekuivalentet e saj, llogari te arketueshme, detyrime te tjera te pagueshme.

Shoqeria nuk zoteron instrumenta financiare me vlere tregu ose te mbajtura per shitje, si edhe garanci financiare deri me 31 Dhjetor 2013 dhe ne fund te vitit 2012.

(i)Njohja fillestare

Nje instrument financiar njihet nese Shoqeria behet pale e dispozitave kontraktuale te instrumentit ne fjale. Blerjet dhe shitjet e rregullta te aktiveve financiare kontabilizohen ne daten e tregetimit, psh daten ne te cilen Shoqeria angazhohet ne blerjen apo shitjen e nje aktivi financiar.

Instrumentat njihen fillimisht me vleren e drejte, ndersa atyre instumentave qe s'jane me vlere te drejte, permes pasqyres permbledhese te te ardhurave, iu shtohet cfaredo lloj kosto transaksioni qe mund t'i ngarkohet drejtperdrejt instrumentit financiar.

(ii) Njohja e metejshme

Paraja dhe Ekuivalentet e saj

Paraja dhe ekuvalentët e parasë (mjetet monetare) përfshijnë tepricat e arkës, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllime të pasqyrës së fluksit të parasë, paraja dhe ekuivalentët të saj përfshijnë depozita pa afat dhe ato me një maturimi prej tre muajsh ose më pak që nga data fillestare. Likuiditetet dhe vlera arke te tjera maten me tej me fitim/ humbjet nga zhvleresimet.

Llogarite e arketueshme tregetare dhe te tjera

Llogarite e arketueshme tregetare dhe te tjera nuk mbartin interes dhe paraqiten me vlere nominale te pakesuar nga zbritjet e nevojshme per shuma qe jane vleresuar te pambledhshme.Vleresimi i shumave te pambledhshme bazohet ne gjykimin e Drejtimit(ne se duhen provizionuar ose jo)..

Huate e Dhëna dhe të Marra

Huate e Dhëna: Huate e arketueshme jane aktive financiare jo-derivative me pagesa te percaktuara ose fikse dhe qe nuk jane te kuotuara ne nje treg aktiv. Pas matjes fillestare, te tilla aktive financiare maten ne vazhdim me kosto te amortizuar duke perdorur metoden e normes se interesit efektiv dhe duke zbritur renien e vleres. Kosto e amortizuar llogaritet duke mare parasysh cdo zbritje ose shtesa te blerjes dhe tarifat ose kostot qe jane pjese perberese e normes efektive te interesit(NEI).Efekti i tyre perfshihet ne rezultatin financiar..

Huatë e marra:Detyrimet financiare, duke perfshire edhe borxhet, jane njohur fillimisht me vleren e tregut neto nga kostot e transaksioneve dhe me pas njihen me koston e amortizuar, duke perdorur metoden e interesit efektiv, me shpenzime interesi te njohura me normen efektive.

Kostot e huamarrjes që lidhen drejtperdrejt me blerjen, ndërtimin ose prodhimin e aktiveve kualifikuese, të cilat jane aktive që kerkojne domosdoshmerish nje periudhe te madhe kohe per t`u bere gati per perdorimin e tyre perfundimtar ose per shitje, i shtohen kostos se ketyre aktiveve deri ne momentin qe keto aktive jane kryesisht gati per tu perdorur ose shitur.

Shoqeria nuk ka marre hua .

Detyrime te pagueshme dhe te tjera

Llogaritë e pagueshme maten fillimisht me vlerën e tyre të drejtë (domethënë me kosto) dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Transaksionet me palet e lidhura

Pale te lidhura jane ato, kur njera prej paleve kontrollohet nga pala tjeter ose ka influence te rendesishme ne vendimarrjen financiare ose te biznesit te pales tjeter.

(iii) Zhvleresimi i Aktiveve Financiare

Nje aktiv financiar konsiderohet si i zhvleresuar ne ato raste kur ekzistojne kushte objektive qe tregojne se nje apo me shume ngjarje pas njohjes se tij fillestare kane patur efekt negativ ne rrjedhen e ardhshme te parase se atij aktivi.

(iv)Ç`rregjistrimi

OPERATORI SISTEMIT TË TRANSMETIMIT ost security

Aktivet financiare ç'regjistrohen nese te drejtat kontraktuale te Shoqerise per flukset e parase nga aktivet fmanciare skadojne.
Detyrimet financiare ç'regjistrohen nese detyrimet kontraktuale te Shoqerise te percaktuara ne kontrate skadojne apo jane anulluar.

(v)Kompensimi (Netimi) i instrumentave financiare

Aktivet dhe pasivet financiare netohen dhe shuma e tyre raportohet neto ne pasqyren e pozicionit financiar nese, dhe vetem nese egziston nje e drejte e detyrueshme ligjore per te netuar shumen e njohur dhe egziston mundesia per te shlyer shumen neto, apo per te realizuar aktivin dhe shlyer pasivin ne te njejten kohe.

f) Provigjionet

Provigjionet njihen kur Shoqeria ka nje detyrim aktual (ligjor ose te terthorte) si rezultat i nje ngjarjeje te shkuar per te cilen ka mundesi qe te krijohen nje rrjedhe burimesh te nevojshme per te permbushur detyrimin dhe kur nje perllogaritje e besueshme e shumes se detyrimit mund te llogaritet.
Provigjionet rishikohen ne cdo date raportimi dhe nese nuk ka me mundesi per nevojen e nje rrjedhe burimesh qe perfshin perfitime ekonomike per shlyerjen e detyrimit, provigjonet rimerren. Provigjionet perdoren vetem per qellimin per te cilinjane njohur fillimisht.
Pasivet dhe aktivet e kushtezuara nuk njihen, por vetem paraqiten ne shenimet e pasqyrave financiare te ndermjetme kur jane materiale.
Shoqeria nuk ka njohur provizione.

g) Qirate

Qirate klasifikohen si qira financiare ose qira operative qe ne fillirnin e qirase. Qirate financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare ne shkallen me me te voglen midis vleres se drejte te aktivit dhe vleres aktuale te pagesave minimale te qirase ne daten e manjes.Kosto financiare paraqet diferencen midis detyrimit total te qirase dhe vleres se drejte te aktivit. Kostot financiare jane regjistruar ne pasqyren e ndermjetme permbledhese te te ardhura gjate kohezgjatjes se qirase me norma interesi te aplikueshme mbi balancen e mbetur te detyrimeve.

h) Inventaret

Inventaret jane vleresuar me me te voglen ndermjet kostos dhe vleres neto te realizueshme. Kosto e inventareve bazohet ne metoden e kostos mesatare te ponderuar, dhe perfshin shpenzime te hasura ne blerjen e inventareve, prodhimin apo kostot e transformimit dhe shpenzime te tjera te hasura deri ne sjelljen e tyre ne kushtet dhe vendin ekzistues. Ne rastin e inventareve te prodhuar dhe punimit ne proces, kosto perfshin edhe nje pjese te pershtatshme te shpenzimeve te pergjithshme te prodhimit bazuar ne kapacitetin normal operativ. Vlera neto e realizueshme eshte cmimi i shitjes i pritur ne kushtet normale te biznesit, minus kostot e pritura te perfundimit dhe shpenzimet e nevojshme te vleresuara per te kryer shitjen.

i) Dividende

Shoqeria shperndan dividend dhe synon te njohe ate (dividentin) si detyrim ne periudhen ne te cilen ndodh veprim.

j) Kapitali Aksioner

Aksionet e zakonshme klasifikohen si kapitali regjistruar(aksioner).Kapitali aksioner njihet me vlerën nominal.

k) Angazhime dhe detyrime te mundshme

Detyrimet e mundshme nuk njihen ne pasqyrat financiare. Ato jepen ne formen e shenimeve shpjeguese pervec rasteve kur eshte e sigurte qe do kete nje fluks dales burimesh qe mbartin perfitime ekonomike. Nje aktiv i mundshem nuk njihet ne pasqyrat financiare por vetem jepet ne formen e shenimeve shpjeguese kur pritet te kete nje fluks hyres perfitimesh ekonomike. Vlera e nje humbje te mundshme njihet si provizion nese ka mundesi qe ngjarje te ardhshme do te konfirmohen, nje detyrim do te haset ne daten e pasqyres se pozicionit financiar dhe mund te behet nje vleresim i arsyeshem i shumes se humbjes

l) Perfitimet e Punonjesve

- *Kontributet e detyrueshme per sigurimet shoqerore*

Shoqeria paguan vetem kontributet per sigurimet e detyrueshme shoqerore qe sigurojne pension per punonjesit. Qeveria shqiptare eshte pergjegjese per caktimin e minimumit te kontributit per

OPERATOR SISTEMIT TË TRANSMETIMIT ost security

sigurimet shoqerore ne Shqiperi sipas nje plani pensioni bazuar ne kontribute. Kontributet e shoqerise ne planin e pensionit jane pasqyruar ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve kur ndodhin

a) *Ngjarje pas dates se bilancit*

Ngjarjet pas dates se bilancit qe permbajne informacion shtese te Shoqerise, ne daten e Bilancit Kontabel (ngjarjet rregulluese) jane reflektuar ne Pasqyrat Financiare. Ngjarjet pas bilancit qe nuk jane ngjarje rregulluese paraqiten te shpalosura ne shenimet shpjeguese te pasqyrave financiare kur jane materiale.

2.3 Ndryshime në politikat Kontabel dhe paraqitjet kontabel

Lista e mëposhtme tregon SNRF/IFRS (dhe ndryshimet në SNRF-të) që janë efektive për herë të parë për Entitetet për vitin financiar 31 dhjetor 2013.

1. SNRF 1: Adoptimi për Herë të Parë i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar - (Amendamentet - Huatë Qeveritare)
2. SNRF 1: Adoptimi për Herë të Parë i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar - (Përmirësimet në SNRF-të (Cikli 2009-2011))
3. SNRF 7:Instrumentet Financiare: Paraqitja (Amendamentet – Dhënia e informacioneve shpjeguese - Kompensimi i aktiveve dhe detyrimeve financiare)
4. SNRF 10 :Pasqyrat e konsoliduara financiare
5. SNRF 11: Marrëveshjet e përbashkëta
6. SNRF 12: Dhënia e informacioneve shpjeguese të Interesave në subjektet e tjera
7. Pasqyrat e konsoliduara financiare, Marrëveshjet e përbashkëta dhe Dhënia e informacioneve shpjeguese të Interesave në subjektet e tjera : Udhëzime Tranzicioni (Ndryshimet në SNRF 10 , SNRF 11 dhe SNRF 12)
8. SNRF 13: Matja me vlerën e drejtë
9. SNK 1: Paraqitja e Pasqyrave Financiare (Ndryshimet) dhe Përmirësimet në SNRF-të (Cikli 2009-2011))
10. SNK 16: Aktivet Afatgjata & Pajisjet - (Përmirësimet në SNRF-të (Cikli 2009-2011))
11. SNK 19: Përfitimet e punonjësve (Ndryshimet)
12. SNK 27: Pasqyrat financiare të ndara (Ndryshimet)
13. SNK 28: Investime në Pjesëmarrje dhe sipërmarrjet e përbashkëta (Ndryshimet)
14. SNK 32: Instrumentet financiare: Paraqitja (Përmirësimet në SNRF-të (Cikli 2009-2011))
15. SNK 34: Raportimi Financiar i ndërmjetëm - (Përmirësimet në SNRF-të (Cikli 2009-2011))

Lista e mëposhtme tregon të SNRF-ve (dhe ndryshimet në SNRF-të) që janë lëshuar, por nuk janë të detyrueshme në fuqi më 31 dhjetor 2013

1. SNRF 1: Adoptimi për Herë të Parë i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (Amendamentet - Cikli 2011-2013)
2. SNRF 3 :Kombinimet e Biznesit (Amendamentet - Cikli 2010-2012) dhe Amendamentet - Cikli 2011-2013))
3. SNRF 7: Instrumentet Financiare: Paraqitja (Amendamentet - Tranzicioni Shpalosjet)
4. SNRF 8: Segmentet Operative (Amendamentet - Cikli 2010-2012)
5. SNRF 9 :Instrumentat Financiare Ndryshimet dhe Hyrja në fuqi e detyrueshme)
6. SNRF 10 :Pasqyrat konsoliduara financiare (Amendamentet - Njësitë ekonomike për investime)
7. SNRF 13: Matja e vleres se drejte (Amendamentet - Cikli 2010-2012)
8. SNRF 13:Matja e vleres se drejte (Amendamentet - Cikli 2011-2013)
9. SNK 16: Aktivet Afatgjata Materiale (Amendamentet - Cikli 2010-2012)
10. SNK19: Përfitimet e punonjësve (Amendamentet - Planet për përfitime të përcaktuara: Kontributet e punonjësve)

OPERATORI SISTEMIT TË TRA... LIMIT ost security

11. SNK 24 Dhënia e informacioneve shpjeguese për palët e lidhura (Amendamentet - Cikli 2010-2012)
12. SNK32:Instrumentet financiare: Paraqitja (Amendamentet - Kompensimi i aktiveve dhe detyrimeve financiare)
13. SNK36:Zhvlerësimi i aktiveve (Amendamentet – paraqitja e shumes se rikuperueshme, dhënia e informacioneve shpjeguese për Aseteve jo-financiare)
14. SNK38: Aktivet Jo-materiale (Ndryshimet - Cikli 2010-2012)
15. SNK39: Instrumentet financiare: Njohja dhe Matja (Amendamentet - novacion i derivativëve dhe vazhdimin e kontabilitetit mbrojtës))
16. SNK 40: Investime Pronës (Amendamentet - Cikli 2011-2013)
17. KIRFN 21: Masë për marrje pasurie.

3. Gjykime, Supozime dhe Çmuarje te rendesishme

Pregatitja e pasqyrave financiare te Shoqerise kerkon nga manaxhimi qe te perdore gjykimin, çmuarjet dhe supozime qe ndikojne mbi vlerat e raportuara te te ardhurave, shpenzimeve, aktiveve dhe detyrimeve dhe shpalosjeve te detyrimeve te kushtezuara, ne fund te periudhes raportuese. Megjithate, pasiguria ne keto supozime dhe çmuarje mund te rezultoje ne perfundime qe kerkojne nje rregullim material te vleres se mbartur te aktivit ose detyrimit qe ndikohet ne periudhat e mevonshme.

Manaxhimi i larte i Shoqerise mbikqyr manaxhimin e ketyre risqeve.

✓ ***Çmuarjet dhe supozimet***

Supozimet kryesore te lidhura me te ardhmen dhe burime te tjera kryesore te pasigurise ne çmuarje ne daten e raportimit, qe kane nje risk te madh te shkaktimit te nje rregullimi material te vleres se mbartur te aktivit dhe detyrimit brenda vitit financiar te ardhshem pershkruhen me poshte. Shoqeria i bazon supozimet dhe cmuarjet e saj ne parametra qe ekzistojne ne daten kur jane pregatitur pasqyrat financiare. Megjithate, rrethanat dhe supozimet ekzistuese ne lidhje me zhvillime te ardhshme, mund te ndryshojne per shkak te ndryshimeve ne treg, apo rrethanave qe jane jashte kontrollit te Shqoerise. Te tilla ndryshime reflektohen ne supozime kur ndodhin.

Rivleresimi i aktiveve afatgjata materiale

Gjate vitit 2013 shoqeria nuk ka kryer rivleresim te aktiveve afatgjate materiale

Renia e vleres e aktiveve jo-financiare

Nje renie vlere ekziston kur vlera e mbartur e nje aktivi apo njesie gjeneruese te parase tejkalon vleren e rikuperueshme te tij qe eshte me e larta ndermjet vleres se drejte pakesuar me kostot e shitjes dhe vleres ne perdorim. Llogaritja e vleres se drejte pakesuar me kostot e shitjes bazohet ne te dhenat ekzistuese prej transaksioneve detyruese te shitjes ne transaksione me vlere tregu per aktive te ngjashme ose cmime tregu te vezhguara pakesuar me kostot shtese per nxjerrjen e aktivit jashte perdorimit. Llogaritja e vleres ne perdorim bazohet ne modelin e skontimit te flukseve monetare. Vlera e rikuperueshme eshte me e ndjeshme ndaj normes se skontimit te perdorur per modelin e skontimit te flukseve monetare, si dhe vlerave hyrese te pritshme dhe normes se rritjes te perdorur per qellim ekstrapolimi.

Gjate vitit 2013 shoqeria nuk ka llogaritur Renie vlere per aktivet jo –fianciare

Inventaret

Mallrat maten me, me te voglen ndermjet kostos dhe vleres neto te realizueshme. Ne percaktimin e vlerave neto te realizueshme, drejtimi mer parasysh evidencen me te besueshme ekzistuese ne kohen kur jane bere çmuarjet.

Gjate vitit 2013 shoqeria nuk ka llogaritur ndonje çmuarje per inventaret.

OPERATORI SISTEMIT TË TRANSMETIMIT ost security

4. Aktivet Afagjata Materiale(AAM)

	Inventari ekonomik	Paisje informatike	Total
Vlera bruto e AAM me ,31.12.2012	422,102	617,583	1,039,685
Shtesa gjate 2013			-
AAM me 31 dhjetor 2013	422,102	617,583	1,039,685
Amortizimi i akumuluar 31.12.2012	139,786	215,375	355,162
Amortizimi 2013	56,463	100,552	157,015
Shtesa			-
Amortizimi I akumuluar, 31 dhjetor 201	196,250	315,927	512,177
Vlera neto e AAM 2013	225,852	301,656	527,508
Vlera neto e AAM 2012	282,316	402,208	684,524

5. Inventarët

	31.12.2013 ne Lek	31.12.2012 ne Lek
Materiale te ndryshme	221,212.7	926,293
Materiale te paperdorshme	-	-
Zhvleresim Inventaresh	-	-
	221,213	**926,293**

6. Llogari të Arkwtueshme dhe tjera të Arkëtueshme (afatshkurtwr)

	31.12.2013 ne Lek	31.12.2012 ne Lek
Llogari te arketueshme tregetare	14,548,706	11,621,481
Llogari te arketueshme e te tjera	241,355	293,886
	14,790,061	**11,915,367**

7. Shpenzime per t`u shperndare ne disa periudha

	31.12.2013 ne Lek	31.12.2012 ne Lek
Shpenzime per t`u shperndare	3,172,171.4	1,807,217
	3,172,171	**1,807,217**

OPERATORI SISTEMIT TË TRANSMETIMIT ost security

8. Mjetet Monetare

	31.12.2013 ne Lek	31.12.2012 ne Lek
Llogari rrjedhese ne Banke	1,668,682	745,295
Mjete monetare ne arke	29,620	15,327
	1,698,302	**760,622**

9. Kapitali i regjistruar

Struktura e kapitalit aksioner eshte si vijon:

31.12.2013

	Nr.Kontributeve	Vlera nominale e aksionit	Struktura e Kapitalit regjistruar	Kapitali i aksionar
OST sha.	4,000.00	1,000.00	100%	**4,000,000.00**

31.12.2012

	Nr.Kontributeve	Vlera nominale e aksionit	Struktura e Kapitalit regjistruar	Kapitali i aksionar
OST sha.	4,000.00	1,000.00	100%	**4,000,000.00**

10. Llogari te Pagueshme

	31.12.2013 ne Lek	31.12.2012 ne Lek
Furnitore vendas	264,522	209,857
	264,522	**209,857**

11. Llogari te Pagueshme ndaj Punonjesve

	31.12.2013 ne Lek	31.12.2012 ne Lek
Pagat e punonjesve per t'u paguar	5,817,270	5,642,509
	5,817,270	**5,642,509**

OPERATORI SISTEMIT TE TRANSMETIMIT ost security

12. Detyrime Tatimore

	31.12.2013	31.12.2012
	ne Lek	ne Lek
Detyrime per sigurime shoqerore & shendetesore	2,078,490	2,016,781
Detyrime per tatimin mbi te ardhurat personale	753,730	732,127
Detyrime per TVSH	1,961,480	1,893,704
Tatim mbi te ardhurat	-	0
Tatim ne burim	15,000	539,850
	4,808,701	**5,182,462**

13. Llogari te Tjera te Pagueshme

	31.12.2013	31.12.2012
	ne Lek	ne Lek
Detyrime kundrejt OST sha	5,724,066	2,391,253
Kreditoret te tjere	515,506	520,380
	6,239,572	**2,911,633**

14. Të Ardhurat Neto

	31.12.2013	31.12.2012
	ne Lek	ne Lek
Te ardhura nga shitja	118,645,992	113,429,304
Te ardhura te tjera Operative	1,421,103	874,178
	120,067,095	**114,303,482**

15. Shpenzime Materiale

	31.12.2013	31.12.2012
	ne Lek	ne Lek
Materiale te para dhe te konsumueshme	3,250,181	2,975,657
	3,250,181	**2,975,657**

16. Shpenzimet per Personelin

	31.12.2013	31.12.2012
	ne Lek	ne Lek
Shpenzime per Pagat	73,161,826	92,669,673
Shpenzime per Sigurime shoqerore e Shendetesore	14,668,919	14,268,585
Shpenzime te tjera per personelin	20,887,000	-
	108,717,745	**106,938,258**

17. Shpenzimet per Amortizimin dhe Zhvleresimi

	31.12.2013	31.12.2012
	ne Lek	ne Lek
Shpenzime amortizimi per AAM-ve	157,015	195,679
	157,015	**195,679**

18. Shpenzime te Tjera

	31.12.2013 ne Lek	31.12.2012 ne Lek
Shpenzime per Energji lektrike	238,566	225,045
Qera zyra dhe armatimi	1,928,000	1,992,000
Mirmbajtje Riparime	236,634	229,348
Primi I Sigurimit	20,250	179,663
Te Ndryshme	528,739	360,835
Honorare per personel te jashtem	900,000	900,000
Udhetim e Dieta	671,200	1,021,210
Shpenzime postare dhe telekomunikacioni	1,812,360	921,558
Sherbime bankare	31,895	42,470
Taksa Vendore e tatime te tjera	25,120	25,120
Taksa Regjistrimi	-	7,592
Gjoba penalitete	432,178	173,511
	6,824,942	**6,078,351**

19. Te Ardhura dhe Shpenzime Financiare (Neto)

	31.12.2013 ne Lek	31.12.2012 ne Lek
Te ardhura nga Interesat	14,418	32,025
Shpenzimet nga Interesat	-	-
Te ardhurat nga kembimi kursit	-	-
Shpenzimet nga kembimi kursit	-	-
Te ardhura te tjera financiare	-	-
Shpenzime te tjera financiare	-	-
	14,418	**32,025**

20. Rezultatit Tatimore dhe Tatimi mbi Fitimin

	31.12.2013 ne Lek	31.12.2012 ne Lek
Fitimi (Humbje) para Tatimit	**1,131,630**	**(1,852,438)**
Shpenzime te panjohura	432,178	173,511
Humbje e mbartur	(1,678,927)	0
Fitimi (Humbje) Tatimore	**(115,119)**	**(1,678,927)**
Efektet e tatimit te shtyre	0	**0**
Tatimi mbi Fitimin	0	0
Fitimi (Humbje) NETO	**1,131,630**	**(1,852,438)**

21. Vleresimet e vleres drejte

Vlera e drejte e aktiveve dhe detyrimeve financiare perfshihet ne shumen me te cilen instrumenti mund te shkembehet ne nje transaksion aktual ndermjet paleve me informacion te mjaftueshme me vullnet te lire dhe jo ne nje shitje te forcuar apo ne likuidim.

Metodat dhe supozimet e meposhtme jane perdorur per te vleresuar vleren e drejte:

- ✓ Mjetet monetare dhe depozitat afatshkurtra, llogarite e arketueshme, llogarite e pagueshme dhe te tjera detyrime afatshkurtra perafrojne me vleren e tyre te mbartur, kryesisht per shkak te maturitetit afatshkurter te ketyre instrumentave.
- ✓ Vlera e drejte e instrumentave jo te kuotuar, huate afatgjate nga institucionet financiare, si dhe detyrimeve te tjera afatgjata percaktohet duke skontuar flukset monetare te ardhshme duke perdorur normat e interesit te tregut per instrumenta financiar me terma te ngjashme ne lidhje me riskun e kreditit dhe maturitetin e mbetur.

- **Instrumentat financiare te paraqitur me vlere te drejte:**

Aktivet financiare te matura sipas vleres se drejte ne pasqyren e pozicionit financiar jane ne perputhje me hierarkine e vleres se drejte e cila grupon aktivet dhe detyrimet financiare ne tre nivele bazuar ne rendesine e te dhenave te perdorura gjate matjes se vleres se drejte te aktivit financiar. Hierarkia e vleres se drejte eshte si me poshte:

- **Niveli 1**: Çmimet e kuotuara ne tregjet aktive per aktive apo detyrime identike ose te atyre qe jane pjese e vleresimit.
- **Niveli 2**: Te tjera te dhena pervec çmimeve te kuotuara te perfshire ne nivelin 1 te cilat jane te disponueshme per aktivet apo detyrimet duke vezhguar direkt (p.sh: cmimet) ose indirekt (p.sh: cmime te rregulluara), dhe,
- **Niveli 3**: te tjera te dhena per aktivin apo detyrimin qe nuk bazohen duke vezhguar te dhenat e disponueshme ne tregje.

Me 31 Dhjetor 2013 dhe 2012 Shoqeria nuk ka instrumenta financiare te njohur me vlere te drejte.

- **Instrumentat financiare te njohura jo me vlere te drejte:**

Diferenca ndermjet vleres se mbartur dhe vleres se drejte te ketyre aktiveve dhe detyrimeve financiare qe nuk jane njohur me vlere te drejte ne pasqyren e pozicionit financiar paraqiten ne tabelen si me poshte:

31 Dhjetor 2013	Vlera e mbartur	Vlera e drejte
Aktivet		
Mjete monetare	1,698,302	1,698,302
Llogari dhe te tjera te arketueshme	14,790,061	14,790,061
	16,488,362	16,488,362
Detyrimet		
Llogari te pagueshme -Det.Tatimore	12,321,364	12,321,364
	12,321,364	12,321,364

31 Dhjetor 2012	Vlera e mbartur	Vlera e drejte
Aktivet		
Mjete monetare	760,622	760,622
Llogari dhe te tjera te arketueshme	11,915,366.6	11,915,366.6
	12,675,989	12,675,989
Detyrimet		
Llogari te pagueshme -Det.Tatimore	8,763,999	8,763,999
	8,763,999	8,763,999

Llogari te arketueshme dhe te tjera te arketueshme
Vlera e drejte e perllogaritur e tyre perfaqeson shumen per tu mbledhur e siguruar kjo nga vleresimi i historise se pageses se debitorit, si dhe te mundesise dhe pozicionit aktual financiar dhe statusit.Vlera e drejte e llogarive te arketueshme dhe te tjera te arketueshme perafron me vleren e mbartur te tyre

Aktivet Likuide
Aktivet likuide konsistojne kryesisht ne gjendjet e llogarive rrjedhese te bankave. Rrjedhimisht vlera e mbartur e tyre i korespondon vleres se drejte.
Llogarite e pagueshme dhe te tjera detyrime
Llogarite e pagueshme dhe te tjera detyrime te Shoqerise kane maturitet afatshkurtra. Rrjedhimisht, vlera e mbartur e tyre i korespondon vleres se drejte.

Instrumentat financiare sipas kategorive
Vlerat e mbartura te aktiveve dhe detyrimeve financiare te Shoqerise sikurse jane njohur ne daten e pasqyres se pozicionit financiar persa i perket periudhave ne rishikim mund te kategorizohen si me poshte:

Aktivet	31.12.2013	31.12.2012
Mjete monetare	1,698,302	760,622
Llogari dhe te tjera te arketueshme	14,790,061	11,915,367
	16,488,362	12,675,989

Detyrimet	31.12.2013	31.12.2012
Llogari te pagueshme dhe te tjera detyrime	12,321,364	8,763,999
	12,321,364	8,763,999

22. Palet e lidhura
Kompensimi i manaxhereve kryesore te Shoqerise
Shoqeria konsideron si pale te lidhura drejtorin e saj dhe anetaret e keshillit mbikqyres.
Marredhenie me Kompani te lidhura

Palet e Lidhura	**31.12.2013**	**31.12.2012**
Administrator	1,488,000	1,488,000
Keshilli Mbikqyres	900,000	900,000
	2,388,000	2,388,000

	Nr	**Nr**
Palet e lidhura		
Administratore	1	1
Keshill Mbikqyres	4	4

OPERATORI SISTEMIT TE TRAN... SHPK
OST security

	31.12.2013	31.12.2012
Shitje Shoqerive te lidhura	118,645,992	113,429,304
OST sh.a.	*7,754,640*	*7,413,680*
Njesit Operative	*110,891,352*	*106,015,624*
Blerje nga Shoqerite e lidhura	0	0
OST sh.a.	0	0
Njesit Operative	0	0
Te drejtat ndaj shoqerise nga palet e lidhura	14,548,706	11,621,481
OST sh.a.	*775,464*	0
Njesit Operative	*13,773,242*	*11,621,481*
Detyrime ndaj paleve te lidhura	5,724,066	2,391,253
OST sh.a.	*5,724,066*	*2,391,253*
Njesit Operative		

23. Angazhime dhe detyrime te kushtezuara

Çeshtje gjyqesore

Deri me 31 Dhjetor 2013 Shoqeria ka 7 (shtate) ceshtje gjyqesore te hapur kundrejt saj, qe mund te kerkoje rregullime te ketyre pasqyrave financiare.

Detyrimet tatimore

Librat e Shoqerise nuk jane audituar nga organet tatimore per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2013. Si rrjedhoje detyrimet tatimore nuk mund te konsiderohen perfundimtare. Detyrirne te mundshme qe mund te rezultojne nga nje auditim i organeve tatimore nuk mund te maten ne menyre te besueshme.

24. Objektivat dhe Politikat e Manaxhimit te Riskut Financiar

Shoqeria "OST Security "sha eshte me capital 100% te OST sha.Krijimi i kesaj shoqerie ka qene per qellime te vecanta te vete shoqerise meme (OST sha).

Manaxhimi i larte i Shoqerise "OST" sha mbikqyr manaxhimin e ketyre risqeve ne menyre te konsoliduara .

Më poshte po paraqesim nje intepretim te ketyre rrisqeve te bashkerenduara me shoqerine mëmë (OST sha.):

Risku i tregut

Risku i tregut eshte risku qe sjell ndryhimin e te drejtes se flukseve monetare te ardhshme te nje instrumenti financiar i cili do te varioje per shkak te ndryshimeve ne cmimet e tregut. Çmimet e tregut perfshijne kater tipe risqesh risku i normes se interesit, risku i kursit te kembimit, risku i cmimit te mallrave/sherbimeve dhe risqe te tjera te cmimeve, te tilla si risku i cmimit te kapitalit. Instrumentat financiar te prekur nga risku i tregut perfshijne huate dhe kredite dhe depozitat.

Risku i normes se interesit

Risku i normes se interesit perbehet nga risku qe vlera e flukseve monetare te ardhshme te nje instrumenti financiar do te varioje per shkak te ndryshimeve ne normat e interesit ne treg dhe riskut qe maturitetet e aktiveve qe mbartin interes te ndryshojne nga maturitetet e detyrimeve qe mbartin interes te perdorura per te financuar ate aktive.Zgjatja kohore pergjate te ciles norma e interesit e nje instrumenti financiar eshte fikse, percakton se ne cfare mase eshte e ekspozuar

OPERATORI I SISTEMIT TË TRANSMETIMIT ost security

ndaj riskut te normes se interesit. Aktivet dhe detyrimet e Shoqerise mbartin norma interesi te tregut.

Risku i kursit te kembimit

Risku i kursit te kembimit eshte risku qe vlera c drejte e flukseve monetarc te ardhshme te nje instrumenti financiar do te varioje per shkak te ndryshimeve ne kursin e kembimit te monedhave te huaja. Ekspozimi i Shoqerise ndaj riskut te ndryshimit te kursit te kembimit te monedhave te huaja lidhet kryesisht me aktivet dhe detyrimet e Shoqerise ne monedha te huaja. Shoqeria eshte e ekspozuar ndaj riskut te kursit te kembimit, si rjedhoje e ekspozimit ne disa monedha te huaja kryesisht ne lidhje me Euron. Shoqeria nuk perdor instrumenta mbrojtes kundrejt riskut te kursit te kembimit. Manaxhimi i Shoqerise eshte pergjegjes per te mbajtur nje pozicion neto te pershtatshem ne çdo monedhe dhe monitoron operacionet ditore.

Risku i kreditit

Risku i kreditit eshte risku qe nje pale tjeter nuk do te jete ne gjendje te paguaje detyrimet e saj qe rrjedhin nga nje instrument financiar ose marreveshje klienti, duke çuar keshtu ne nje humbje financiare. Shoqeria eshte e ekspozuar ndaj riskut te kreditit per shkak te aktiviteteve operacionale te saj (pikesepari prej llogarive te arketueshme) dhe prej aktiviteteve te saj financuese, qe perfshijne depozitat me bankat dhe institucionet financiare, transaksionet ne monedha te huaja dhe instrumenta te tjere financiare, Me 31 Dhjetor 2013 dhe 2012 Shoqeria nuk ka vlera te konsiderueshme llogarish te arketueshme dhe depozitash me bankat dhe institucionet financiare, si njedhoje nuk ka ndonje perqendrim te madh te riskut te kreditit.

Risku i likuiditetit

Risku i likuiditetit eshte risku qe Shoqeria mund te mos jete ne gjendje te paguaje detyrimet e saj te lidhura me detyrimet financiare ne momentin e pageses. Risku i likuiditetit eshte risk i qenesishem ne biznesin e Shoqerise pasi disa aktive specifike te blera apo detyrime te shitura mund te kene karakteristika likuiditeti qe jane specifike. Nese Shoqeria do ti duhet te kete shuma te medha ne nje afat te shkurter kohor qe tejkalon kerkesat normale per mjete monetare mundet qe te ndeshet me veshtiresi per te siguruar cmime joshese. Shoqeria manaxhon riskun e likuiditetit duke monitoruar ne menyre te vazhdueshme parashikimet dhe flukset monetare aktuale dhe duke u munduar te perputhe profilet e maturitetit te aktiveve dhe detyrimeve.

OPERATORI SISTEMIT TE TRANSMETIMIT
OST security

31 Dhjetor 2013	Deri ne 6 muaj	6-12 muaj	1-2 vjet	Totali
Aktive financiare				
Mjete monetare	1,698,302	-	-	1,698,302
Llogari te arketueshme dhe te tjera te arketueshme	14,790,061	-	-	14,790,061
Totali aktiveve financiare	**16,488,362**	-	-	**16,488,362**
Detyrime financiare				
Llogari te pagueshme dhe te tjera detyrime	12,321,364			12,321,364
Totali detyrimeve financiare	**12,321,364**	-	-	**12,321,364**
Hendeku i maturimit	**4,166,999**			

31 Dhjetor 2012	Deri ne 6 muaj	6-12 muaj	1-2 vjet	Totali
Aktive financiare				
Mjete monetare	760,622	-	-	760,622
Llogari te arketueshme dhe te tjera te arketueshme	11,915,367	-	-	11,915,367
Totali aktiveve financiare	**12,675,989**	-	-	**12,675,989**
Detyrime financiare				
Llogari te pagueshme dhe te tjera detyrime	8,763,999	-	-	8,763,999
Totali detyrimeve financiare	**8,763,999**	-	-	**8,763,999**
Hendeku i maturimit	**3,911,989**	-	-	**3,911,989**

Manaxhimi i kapitalit

Kapitali perfshin kapitalin qe i perket mbajtesve te pjeseve kapitalit te shoqerise meme. Objektivi kryesor i manaxhimit te kapitalit te Shoqerise eshte te siguroje qe po mban nje kapital te shendoshe per te mbeshtetur biznesin e saj dhe te maksimizoje vleren e aksionereve. Shoqeria manaxhon strukturen e kapitalit te saj dhe ben rregullirnet e nevojshme ne rast se ka ndryshime ne kushtet ekonomike.Per te ndryshuar apo mbajtur strukturen e saj te kapitalit, Shoqeria mund te rregulloje shperndarjen e dividentit per aksioneret e saj, t'ju ktheje kapitalin aksionereve ose te emetoje aksione te reja.

25. Ngjarje pas dates se bilancit

Me 31 Dhjetor 2013 ne daten e pasqyrave financiare dhe deri ne daten e aprovimit te tyre nuk ka ngjarje rregulluese te reflektuara ne pasqyrat financiare ose ngjarje qe jane materialisht te rendesishme per te paraqitur ne keto pasqyra.

Administratori

Rustem M

Hartuesi i Pasqyrave Financiare

Afrime Haklaj

_____, më __/__/2014

OST SECURITY SH.a

TIRANE

Faqe nr.____

FLETE INVENTARIZIMI I date 31.12.2013

Nr	Emertimi	Njesia	Cmimi	Gjendja sipas te dhenave kontabile		gjendja sipas sipas inventarit		Rezultatet				Numuri karteles sipas librit te magazine
								Mungesat		Tepricat		
				sasia	Vlera	sasia	Vlera	Sasia	vlera	Sasia	vlera	
1	Binder klips 41	cope	180	1	180	1	180	x	x	x	x	
2	Binder klips.	"	208.33	5	1041.65	5	1041.65	x	x	x	x	
3	Binder klips.	"	208.5	4	834	4	834	x	x	x	x	
4	Boje toner Toshiba.	"	2,222.22	1	2,222.22	1	2,222.22	x	x	x	x	
5	Blloqe te verdha	"	41.67	3	125.01	3	125.01	x	x	x	x	
6	CD	"	208.33	2	416.66	2	416.66	x	x	x	x	
7	Dere duralumini.	cope	20000	1	20,000	1	20,000	x	x	x	x	
8	Diezel.	litra	186.442	6	1,118.65	6	1,118.65	x	x	x	x	
9	Dosje me mekaniz	cope	116.67	11	1,283.37	11	1,283.37	x	x	x	x	
10	Dosje me 20 qese.	"	166.67	1	166.67	1	166.67	x	x	x	x	
11	Evidenciator.	"	50	2	100	2	100	x	x	x	x	
12	Fletore.	"	35.429	7	248	7	248	x	x	x	x	
13	Flete hyrje e dalje.	"	65	6	390	6	390	x	x	x	x	
14	Glue Stik I madh.	"	66.67	4	266.68	4	266.68	x	x	x	x	
15	Gershere.	"	125	8	1,000	8	1,000	x	x	x	x	
16	Hapse vrimash	"	333.33	3	999.99	3	999.99	x	x	x	x	
17	Kapse Teli.	"	33.33	5	166.65	5	166.65	x	x	x	x	
18	Kapse aktesh.	"	33.5	10	335	10	335	x	x	x	x	
19	Kalendar tavoline 2013	"	500	1	500	1	500	x	x	x	x	
20	Korrektor Pen.	"	208.33	4	833.32	4	833.32	x	x	x	x	
21	Kemishe me menge gjata.	"	1270	32	40,640	32	40,640	x	x	x	x	
22	Kemishe menge shku shkurtera	"	1170	34	39,780	34	39,780	x	x	x	x	
23	Kepuce gjysma lekure.	Pale	2800	24	67,200	24	67,200	x	x	x	x	
24	Karta identifikimi te punonjes	cope	30	241	7,230	241	7,230	x	x	x	x	
25	Liber magazine.	"	250	1	250	1	250	x	x	x	x	
26	Liber arke.	"	180	1	180	1	180	x	x	x	x	
27	Mandat arketimi.	"	70	5	350	5	350	x	x	x	x	
28	Mandat pagese.	"	70	7	490	7	490	x	x	x	x	

OPERATORI SISTEMIT TË TRANSMETIMIT ost security

29	Makina llogaritese.	"	1,166.67	1	1,166.67	1	1,166.67	x	x	x	x	
30	**Mbajtese dokumentash Leitz.**	"	1,166.67	5	5,833.35	5	5,833.35	x	x	x	x	
31	Qese A4	"	416.67	1	417	1	417	x	x	x	x	
32	Regjister korespondence	"	300	1	300	1	300	x	x	x	x	
33	Skoc 19 x 33.	"	41.67	1	42	1	42	x	x	x	x	
34	Super benzine.	litra	183.54	95	17,436	95	17,436	x	x	x	x	
35	Steller. 24/6.	cope	25	1	25	1	25	x	x	x	x	
36	Tela 23/13	"	100	6	600	6	600	x	x	x	x	
37	Urdher dorezimi.	"	80	1	80	1	80	x	x	x	x	
38	vizore 30 cm	"	125	8	1,000	8	1,000	x	x	x	x	
39	Zarfa te vegjel.	"	2.5	18	45	18	45	x	x	x	x	
40	Zarfa A4.	"	5	20	100	20	100	x	x	x	x	
41	Leter A4.	Rizma	323.334	18	5,820	18	5,820	x	x	x	x	
								x	x	x	x	
					221212.2		221212.2	x	x	x	x	

Magazinjere
Kozeta Dako

KOMISJONI INVENTARIZIMIT

Roland Sheshi	**Kryetar**
Artur Tafa	**Antar**
Xhemal Zagorcani	**Antar**

OPERATORI SISTEMIT TË TRANSMETIMIT
OST security